



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.3269/7 prot.

Datë 03.02.2026

V E N D I M
Nr.192/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 03.02.2026 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik, “Almo Konstruksion” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur”, me nr. REF-64104-10-08-2025, me objekt: “Ndërtimi i infrastruktures së modeleve të integruara në zona me potencial zhvillimi, Divjakë: “Ferma e dijes dhe agroturizmit të ullishteve, Divjakë”, me fond limit 458,267,729.76 lekë (pa tvsh), zhvilluar me date 27.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik, “Ndregjoni” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Ankimues: Operatori ekonomik “Z D R A V A” SHPK, me NIPT J84003411K, dhe adresë: Autostrada Lushnje-Fier km 4, Pasuria me nr 104/20 në zonën kadastrale 3, Lushnje.

Subjekte të interesuar: Operatori ekonomik “Almo Konstruksion” SHPK, me NIPT J91915001P dhe adresë : Lagjia Zall - Mner i Ri, Rruga Nacionale Kamez, 1054, Tiranë.

Operatori ekonomik “Ndregjoni” SHPK, me NIPT K31329048I dhe adresë: Njesia Bashkiake Nr. 8, Rruga Sule Bega, Ndertesa Nr. 32, Hyrja 8, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Fondi Shqiptar i Zhvillimit
Adresa: Rruga “Sami Frashëri”, nr. 10, Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021, “*Për miratimin e rregullave ‘Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik’*”, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020, datë 5.11.2020, “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt - ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30, të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 09.10.2025, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit prokurimit “E hapur”, me nr. REF-64104-10-08-2025, me objekt: “Ndërtimi i infrastruktures së modeleve të integruara në zona me potencial zhvillimi, Divjakë: “Ferma e dijes dhe agroturizmit të ullishteve, Divjakë”, me fond limit 458,267,729.76 lekë (pa tvsh), zhvilluar me date 27.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

II.2. Në datën 27.10.2025 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datën 03.11.2025, ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

BOE Almo Konstruksion & Ina	346,768,983 lekë	Kualifikuar
	Totali i pikëve	261,45 pikë
BOE Ndrejoni & Rafin Company	355,607,273 lekë	Kualifikuar
	Totali i pikëve	258 pikë
Zdrava	357,774,473.88 lekë	Kualifikuar
	Totali i pikëve	257,25 pikë
BOE Alba Konstruksion & O.B.Konstruksion	335,575,230.43 lekë	Kualifikuar
	Totali i pikëve	255,15 pikë
BOE Senka & G.P.G. Company	338,960,029.95 lekë	Kualifikuar
	Totali i pikëve	249,30 pikë
Curri	329,537,308 lekë	Kualifikuar
	Totali i pikëve	241,05 pikë
Arkonstudio	340,994,766.5 lekë	Kualifikuar

	Totali i pikëve	236,40 pikë
BOE Ante-Group & Nova Construction Group	407,016,484 lekë	Kualifikuar
	Totali i pikëve	209,10 pikë
Agi Kons	400,000,000.93 lekë	Kualifikuar
	Totali i pikëve	206,40 pikë
Salillari	430,000,000 lekë	Kualifikuar
	Totali i pikëve	205,65 pikë
BOE Aurora Konstruksion & Desaret Company	412,013,092.57 lekë	Kualifikuar
	Totali i pikëve	194,70 pikë
BOE Sterkaj & Eral Construction Company	425,411,174 lekë	Skualifikuar
Dion-Al	332,056,787.67 lekë	Skualifikuar
Llazo	340,064,565 lekë	Skualifikuar
BOE Fled & Shkelqimi 07	332,517,519.59 lekë	Skualifikuar
BOE Nika & Mane/S	350,144,481.68 lekë	Skualifikuar
BOE Lis Konstruksion & Viante Konstruksion	314,167,060.34 lekë	Skualifikuar
BOE Ergi shpk & BE - IS	400,846,043 lekë	Skualifikuar
BOE Kacdedja & Agri Construction	343,758,626.37 lekë	Skualifikuar
BOE Albavia & Inerti	394,279,157.91 lekë	Skualifikuar
Vellezerit Hysa	323,646,519.36 lekë	Skualifikuar

II.4. Në datën 10.11.2025, autoriteti kontraktor ka publikuar Njoftim - Fituesi paraparak në sistemin e prokurimeve elektronike, për procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.5. Në datën 14.11.2025, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik 2025/6075 dhe me nr. protokoli 3269/2025, datë 14.11.2025, i operatorit ekonomik “Zdrava” SHPK, duke kundërshtuar vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Almo Konstruksion” SHPK dhe operatori ekonomik “Ndregjoni” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr.3269/1 prot., datë 17.11.2025.

II.7. Nëpërmjet shërbimit postar, autoriteti kontraktor, me shkresën nr. 4653 prot., datë 26.11.2025, protokolluar me tonën me nr.3269/2 prot., datë 02.12.2025, ka përcjellë pranë

Komisionit të Prokurimit Publik vendimin datë 25.11.2025 të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave në lidhje me ankesën e operatorit ekonomik, “Zdrava” SHPK.Referuar vendimit të KSHA rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues dhe në përfundim të shqyrtimit ka vendosur refuzimin e saj.

II.8. Me shkresën nr. 3269/3 prot., datë 13.01.2026 KPP ju drejtua autoritetit kontraktor me kërkesën si vijon: [...] *me qëllim vijimin e gjyqimit të ankesës pranë KPP-së, i nevojitet informacion si më poshtë vijon:*

1. *A ka nënshkruar operatori ekonomik “Almo Konstruksion” SHPK kontratë me autoritetin tuaj kontraktor, në kuadër të procedurës së prokurimit me objekt “Transformim urbannë hapësira publike kryesore, Rajoni 4: Rikualifikimi i rrugës “Butrinti”, Sarandë”, me nr. REF-64583-10-13-2025 ?*
 - *Nëse po, kërkojmë të na vini në dispozicion kopjen e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit (të njësuar me vulën e sekretarisë) të paraqitur nga operatori ekonomik “Almo Konstruksion” SHPK në këtë procedurë prokurimi.*
2. *A ka nënshkruar operatori ekonomik “Ndregjoni” SHPK kontratë me autoritetin tuaj kontraktor, në kuadër të procedurës së prokurimit me objekt “Përmirësimi i Infrastrukturës së Parkimit Faza II: Ndërtim i godinës së parkimit nëntoksor dhe godinës së shërbimeve administrative, Himarë” (Godina e Re)”, me nr. REF-61770-09-17-2025?*
 - *Nëse po, kërkojmë të na vini në dispozicion kopjen e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit (të njësuar me vulën e sekretarisë) të paraqitur nga operatori ekonomik “Ndregjoni” SHPK në këtë procedurë prokurimi*

II.9.. Me shkresën nr.192/1 prot., datë 16.01.2026, protokolluar me tonën me nr.3269/4, datë 19.01.2026, autoriteti kontraktor ka përcjellë pranë KPP informacionin e kërkuar.

II.10. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se nuk janë paraqitur argumente në Sistemin e ankesave elektronike nga operatorë ekonomikë në cilësinë e subjektit të interesuar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur kësaj ankese, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1.Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Zdrava” SHPK, mbi kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Almo Konstruktion” SHPK dhe operatori ekonomik “Ndregjoni” SHPK, me arsyen se: “[...] Lidhja e kontratave të përsëritura me të njëjtin Autoritet kontraktor në një periudhë kaq të shkurtër kohore, çënon konkurrencën efektive dhe krijon dyshim të arsyeshëm për favorizim. Në këtë rast, gjykojmë se ekziston konflikt interesi faktik për shkak të marrëdhënieve kontraktuale të vazhdueshme midis Autoritetit Kontraktor dhe Operatorëve Ekonomik të renditur në vendet e para. Ligji nr.162/2020,Për Prokurimin Publik neni 19 i cili shprehet për konfliktin e interesit parashikon. “1. Autoritetet ose entet kontraktore duhet të marrin masat e përshtatshme për të parandaluar, identifikuar dhe zgjidhur në përputhje me legjislacionin në fuqi rastet e konfliktit të interesit që lindin gjatë kryerjes së procedurave të prokurimit për të shmangur shtrembërimin e konkurrencës dhe për të garantuar trajtimin e barabartë të të gjithë operatorëve ekonomikë... -Të verifikohet konflikti i interesit për të shmangur shtrembërimin e konkurrencës dhe për të garantuar trajtim të barabartë”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në pikën 2. Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 1.a, të shtojcës 7, “Formular i Kriteve të Përzgjedhjes/Kualifikimit”, autoriteti kontraktor ka kërkuar;

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8*

III.1.2.Në përmbushje të kriterit të mësipërm, operatori ekonomik “Almo Konstruktion” SHPK si përfaqësues i BOE “Almo Konstruktion” SHPK & “INA” SHPK “ ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), dokumentacionin si më poshtë:

1. Marrëveshje Bashkëpunimi e lidhur më datë 24.10.2025 ndërmjetë shoqërive “Almo Konstruktion” SHPK & “Ina” SHPK për krijimin e bashkimit të përkohshëm të shoqërive me qëllimin e pjesëmarrjes në procedurën e prokurimit që zhvillon autoriteti kontraktor Fondi Shqiptar I zhvillimit me objekt: “Ndërtimi i infrastruktures së modeleve të integruara në zona me potencial zhvillimi, Divjakë: “Ferma e dijes dhe agroturizmit të ullishteve, Divjakë”.
- Formulari Përmbledhës të Vetëdeklarimit, i operatorit ekonomik “Almo Konstruktion” SHPK ku në Pjesën II: “Shkaqet e përjashtimit”, gërma “C”: “Deklarata mbi konfliktin e interesit’ deklararon:

C: DEKLARATA MBI KONFLIKTIN E INTERESIT

Deklarata

Në cilësimin e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:

Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfshijnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorisë së Përgjithshme, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksioni 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, si dhe Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".



Zall – Mner i Ri, Rruga Nacionale Kamez, 1054, Tiranë -Albania



+355 67 60 06 776

info@almokonstrukcion.com

www.almokonstrukcion.com

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

- Formulari Përmbledhës të Vetëdeklarimit, i operatorit ekonomik “Ina” SHPK ku në Pjesën II: “Shkaqet e përjashtimit”, gërma “C”: “Deklarata mbi konfliktin e interesit” deklaron:

C: DEKLARATA MBI KONFLIKTIN E INTERESIT

Deklarata Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon: Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike. Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë: Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrit, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të

¹ Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, fjalë "konkurrenë" nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që: a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Fiesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor; b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Fiesës për Ofertë.



Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil. Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie. Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005). Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit. Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, si dhe Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik". Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.
--

- Formulari Përmbledhës të Vetëdeklarimit, i operatorit ekonomik "2H – CONSTRUCTION SHPK si subjekt mbështetës i operatorit ekonomik "Almo Konstruktion" SHPK, ku në Pjesën II: "Shkaqet e përjashtimit", gërma "C": "Deklarata mbi konfliktin e interesit" deklaron:



¹ Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, fjala "konkurrentë" nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që: a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Fiesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor; b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Fiesës për Ofertë.

C: DEKLARATA MBI KONFLIKTIN E INTERESIT

Deklarata
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:
Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.
Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:
Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrit, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.
Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.
Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).
Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.
Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, si dhe Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

Ndërsa operatori ekonomik “Ndregjoni” SHPK si përfaqësues i BOE “Ndregjoni Sh.p.k & “Rafin Company Sh.p.k “ ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), dokumentacionin si më poshtë:

- Marrëveshje Bashkëpunimi e lidhur më datë 14.10.2025 ndërmjetë shoqërive “Ndregjoni” SHPK & “Rafin Company” SHPK për krijimin e bashkimit të përkohshëm të shoqërive me qëllimin e pjesëmarrjes në procedurën e prokurimit që zhvillon autoriteti kontraktor Fondi Shqiptar I zhvillimit me objekt: “Ndërtimi i infrastruktures së modeleve të integruara në zona me potencial zhvillimi, Divjakë: “Ferma e dijes dhe agroturizmit të ullishteve, Divjakë”.
- Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit i operatorit ekonomik “Ndregjoni” SHPK ku në Pjesën II: “Shkaqet e përjashtimit”, gërma “C”: “Deklarata mbi konfliktin e interesit’ deklaron:

C: DEKLARATA MBI KONFLIKTIN E INTERESIT

Deklarata

Në cilësimin e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:
Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojnë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:
Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministri, ose Zëvendësministri, Deputeti, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreni i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; siguri; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

¹ Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, fjalat “konkurrenca” nënkuptojnë çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkëpunues ekonomik, që: a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njefimit të Kontrastit dhe/ose të Fletës për Ofertë, të bëjë nga Autoriteti Kontraktor; b) kishin një ofertë në mundësinë, i cili bazuar në kualifikimin, afërsisht ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njefimit të Kontrastit dhe/ose të Fletës për Ofertë.

Adresa : Rr. Sullë Begu, Nr.32, III,
Kod Postar 1017 - Tiranë-Albania

Tel/Fax : + 355 42 374 831. Cel : + 355 68 20 56 734
Email : info@ndregjoni.al



Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksioni 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësisë.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafi 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike”, të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit i Pasurive, si dhe Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”.

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

- Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit i operatorit ekonomik “Rafin Company” SHPK ku në Pjesën II: “Shkaqet e përjashtimit”, gërma “C”: “Deklarata mbi konfliktin e interesit’ deklaron:

C: DEKLARATA MBI KONFLIKTIN E INTERESIT

Dëklaratë Në cilësimet e operatorit ekonomik, në deklaratë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon: Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilin ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojnë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrës dhe detyrës publike. Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluar të përfutrojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë: Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministri, ose Zëvendësministri, Deputeti, Gjyqtari e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtari e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtari dhe Prokurori në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektor i Përgjithshëm i Inspektorit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbrodësor i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energji elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonda; autoritetet e medias).
--

1. Për qëllim të kësaj deklarate dhe qëllimit të paragrafit, fjalë "konflikt i interesit" nënkupton çdo operator ekonomik, si ndryshim nga Qyteti, në paragraf ose jo në bashkim operatorësh ekonomik, që: a) paraqet një ofertë në përputhje të ligjit të Kontraktit dhe/ose të Parës për Ofertë, si bërë nga Autoriteti Kontraktor; b) shërben si ofertë; c) ka bërë një ofertë; d) ka bërë një ofertë; e) ka bërë një ofertë; f) ka bërë një ofertë; g) ka bërë një ofertë; h) ka bërë një ofertë; i) ka bërë një ofertë; j) ka bërë një ofertë; k) ka bërë një ofertë; l) ka bërë një ofertë; m) ka bërë një ofertë; n) ka bërë një ofertë; o) ka bërë një ofertë; p) ka bërë një ofertë; q) ka bërë një ofertë; r) ka bërë një ofertë; s) ka bërë një ofertë; t) ka bërë një ofertë; u) ka bërë një ofertë; v) ka bërë një ofertë; w) ka bërë një ofertë; x) ka bërë një ofertë; y) ka bërë një ofertë; z) ka bërë një ofertë.

RAFIN Nderim-Motim-imp-Esp Adresa: Tiranë, Bregu i Detit, Kulla e Spesialisimit Nr. 2, tel: 069/555 11 11 NDPT: 1321251104, Tel & Fax: Tel / Fax 069/54277799, Mobil: +355 6820 44 447 / +355 68 37 44 447 www.rafin.com.al sektoret e përgjithshme të institucioneve qëndrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik, pozicioni i të cilit është i bashkuar me atë të Drejtorisë të Përgjithshme, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shtetit civil. Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kësaj ligji, seksioni 2 të kësaj ligji, ndalimi në paragrafin 1 të kësaj neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varesë. Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisë vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005). Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafi 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtin masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit. Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, si dhe Ligji Nr. 162/2021, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik". Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se a) zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

III.1.3. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: Qëllimi i kësaj ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.1.4. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të kësaj ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës

dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.1.5. Neni 19 “Konflikti i interesit” i ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht : *1. Autoritetet ose entet kontraktore duhet të marrin masat e përshtatshme për të parandaluar, identifikuar dhe zgjidhur në përputhje me legjislacionin në fuqi rastet e konfliktit të interesit që lindin gjatë kryerjes së procedurave të prokurimit për të shmangur shtrembërimin e konkurrencës dhe për të garantuar trajtimin e barabartë të të gjithë operatorëve ekonomikë. Personat e angazhuar në procesin e prokurimit dhe ekzekutimin e kontratës nuk duhet të jenë në kushtet e konfliktit të interesit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.*

Situata për konfliktin e interesit vlerësohet sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesave dhe në kuptim të këtij ligji mbulon çdo situatë ku titullari ose punonjës të autoritetit ose entit kontraktor ose ofruesit të shërbimit të prokurimit, që vepron në emër të autoritetit ose entit kontraktor, të cilët janë të përfshirë në zhvillimin e procedurës së prokurimit, ose mund të ndikojnë në rezultatin e kësaj procedure kanë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë një interes financiar, ekonomik ose ndonjë interes tjetër personal, që mund të cenojë paanësinë dhe pavarësinë e tyre në vendimmarrjen e procedurës së prokurimit.

2. Autoriteti ose enti kontraktor refuzon një ofertë ose një kërkesë për pjesëmarrje në tender nëse: a) kandidati ose ofertuesi i jep ose premtun t’i japë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, një zyrtari apo punonjësi një shpërblim në çfarëdolloj forme, mundësi punësimi ose mall, shërbim ose vlerë, si stimul për një akt, vendim ose procedurë që ndërmerr autoriteti ose enti kontraktor për procedurat e prokurimit;

b) kandidati ose ofertuesi është në kushtet e konfliktit të interesit sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesave;

c) kandidati ose ofertuesi në të njëjtën procedurë janë në rrethin e personave të lidhur sipas legjislacionit për parandalimin e konfliktit të interesave.

Refuzimi dhe arsyet për një veprim të tillë duhet të dokumentohen dhe i komunikohen menjëherë dhe zyrtarisht kandidatit ose ofertuesit në fjalë.

3. Vendimet e marra nga autoriteti ose enti kontraktor në përputhje me pikën 2 të këtij neni, nuk pengojnë kallëzimin penal në organet përkatëse, kur aktet apo veprimet në fjalë përbëjnë vepër penale.

4. Në rast se gjatë fazës së studimit paraprak të tregut, të përgatitjes së dokumenteve të tenderit ose në momentin e hapjes së ofertave evidentohet se një ose disa prej kandidatëve/ofertuesve ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit me një ose disa prej zyrtarëve të caktuar për studimin e tregut/përgatitjes së dokumenteve të tenderit apo vlerësimin e kërkesave/ofertave dhe kjo situatë konflikti nuk mund të evidentohet përpara këtij momenti, atëherë titullari i autoritetit kontraktor, në varësi të dëmit që mund të jetë shkaktuar, vendos nëse duhet të zëvendësohen

anëtarët e komisioneve të konstatuara në kushtet e konfliktit të interesit e të vijojë procesin apo të anulojë procedurën e prokurimit

Ndërsa në nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht : *“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.”*

III.1.7. Në nenin 21, “Ndalimi i lidhjes së kontratave”, pika 1 të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, parashikohet shprehimisht: *“1. Asnjë individ, kur ky njësohet me një zyrtar në njërin nga funksionet e përcaktuara në kreun III, seksioni 2 të këtij ligji, gjyqtarët e prokurorët në nivelin e gjykatës së shkallës së parë e në atë të apelit, dhe asnjë shoqëri tregtare, ortakëri a shoqëri e thjeshtë, ku ky zyrtar zotëron, në mënyrë aktive apo pasive, aksione a pjesë në kapital, në çfarëdo sasive, nuk mund të lidhë kontratë ose nënkontratë me asnjë institucion publik. Për zyrtarët e nivelit të mesëm drejtues të parashikuar në nenin 31 dhe për zyrtarët e parashikuar në nenin 32 të kreut të III, seksioni 2 të këtij ligji, ndalimi sipas pikës 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave në fushën e territorit dhe të juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë është një institucion i varësisë”.*

III.1.8. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi. KPP-ja gjykon, se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma “dh”, se qëllimi i ligjit të prokurimit publik nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar si ligj material i zbatueshëm për shqyrtimin administrativ të ankesave të operatorëve ekonomikë, është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjithë palët në proces.

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues për skualifikimin e operatorit ekonomik “Almo Konstruksion” SHPK dhe operatorit ekonomik “Ndregjoni” SHPK, me arsyen se: *lidhja e kontratave të përsëritura të dy operatorëve ekonomik të renditur në vendet e para me të njëjtin Autoritet Kontraktor brenda një periudhe të shkurtër kohore, cenon konkurrencën dhe krijon*

dyshim të arsyeshëm për favorizim, KPP sqaron se, në kuptim të nenit 19 të Ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar, konflikti i interesit ekziston në rastet kur personat e përfshirë në zhvillimin e procedurës së prokurimit kanë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, interesa financiare, ekonomike ose personale, të tilla që cenojnë ose rrezikojnë të cenojnë paanësinë dhe pavarësinë e vendimmarrjes së autoritetit kontraktor. Pra, referuar kësaj dispozite konflikti i interesit lidhet me raportin ndërmjet personave të përfshirë në procesin vendimmarrës dhe operatorëve ekonomikë, dhe jo me ekzistencën e marrëdhënieve kontraktore të mëparshme, të ligjshme dhe të përfunduara, ndërmjet autoritetit kontraktor dhe një operatori ekonomik. KPP sqaron se konflikti i interesit, për të qenë i vlefshëm dhe për të prodhuar pasoja në një procedurë prokurimi, duhet të jetë i bazuar në rrethana konkrete, të provuara dhe të lidhura drejtpërdrejt me subjektet e përfshira në vendimmarrje apo përfitim, dhe jo të mbështetet në supozime apo dyshime të përgjithshme. Gjithashtu, neni 21, paragrafi 1 i Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “*Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike*”, parashikon kategori të caktuar zyrtarësh, të cilët janë të ndaluar të lidhin kontrata me institucionet publike ku ata ushtrojnë funksione.

Në rastin konkret pretendimi i ankimesit për konflikt interesit të dy operatorëve ekonomikë “Almo Konstruktion” SHPK dhe “Ndregjoni” SHPK, me autoritetin kontraktor lidhet me faktin që këta dy operatorë ekonomikë kanë lidhur kontrata të përsëritura me të njëjtin autoritet kontraktor në një periudhë të shkurtër kohore dhe jo me rastet e parashikuara në nenin 19 të LPP. Fakti që një operator ekonomik ka qenë kontraktor i mëparshëm i autoritetit kontraktor, si rezultat i një procedure prokurimi, nuk përbën konflikt interesi, për aq kohë sa, nuk provohet ekzistenca e një interesi personal, financiar apo ekonomik të personave përgjegjës të autoritetit kontraktor ndaj këtij operatori ekonomik, nuk provohet ndikim i drejtpërdrejtë ose i tërthortë në vendimmarrjen e procedurës aktuale dhe nuk konstatohet përfshirje e personave në kushtet e parashikuara nga legjislacioni për parandalimin e konfliktit të interesave. Gjithashtu rezulton se, operatorët ekonomikë të sipërpërmendur, të pretenduar nga ankimesi si subjekte në konflikt interesi, në përputhje me kërkesat e dokumenteve të tenderit dhe legjislacionit në fuqi, kanë plotësuar dhe nënshkruar formularin e vetëdeklarimit, duke deklaruar se nuk ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit, sipas parashikimeve të nenit 21, paragrafi 1, të Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “*Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike*”, sikurse paraqitet në pikën III.1.2. të këtij vendimi. Ky vetëdeklarim i konfliktit të interesit, i cili është një detyrim ligjor i operatorëve ekonomikë ofertues, i cili jep një garanci autoritetit kontraktor për respektimin e rregullave mbi konfliktin e interesit, rezulton se është plotësuar në rastin object ankimi nga të dy operatorët ekonomikë për të cilët ngrihen pretendime. Fakti që një operator ekonomik ka lidhur kontrata të mëparshme me të njëjtin autoritet kontraktor, në vetvete, nuk përbën konflikt interesi dhe as shkelje të parimit të konkurrencës. Legjislacioni për prokurimin publik nuk ndalon pjesëmarrjen apo shpalljen fitues të operatorëve ekonomikë që kanë pasur marrëdhënie kontraktuale të mëparshme me autoritetin kontraktor. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se pretendimi për konflikt interesi për dy operatorët

ekonomikë “Almo Konstruksion” SHPK dhe “Ndregjoni” SHPK, me autoritetin kontraktor nuk qëndron.

Për sa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues për skualifikimin e operatorit ekonomik “Almo Konstruksion” SHPK dhe “Ndregjoni” SHPK, me arsyen se: *“Në dokumentat e tenderit kërkohen minimalisht 75 persona per periudhën 3 mujore nga momenti i hapjes së ofertave vërtetuar kjo me vërtetime të lëshuara nga sigurimet shoqërore ose administrata tatimore. Gjithashtu kërkohet staf kryesor i pajisur me diploma, CV dhe kontratë pune. Në bazë të sa më sipër, kërkojmë që: -Të verifikohen listëpagesat dhe vërtetimet e 75 punonjësve të ALMO dhe NDREGJONI per tre muajt e fundit, krahasuar me angazhimet e tyre në çdo kontratë tjetër aktive. Pra verifikimi që i njëjti personel kryesor nuk është kryesor paralelisht në një tjetër kontratë me të njëjtin Autoritet gjatë të njëjtën periudhë” si dhe Të verifikohen marrëdhëniet kontraktuale midis operatorëve të renditur të parët dhe Autoritetit Kontraktor gjatë muajve të fundit.* Komisioni i Prokurimit Publik nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, konstaton, se autoriteti kontraktor në kriteret e veçantë të kualifikimit, nuk ka përcaktuar në asnjë moment që personel kryesor nuk është kryesor paralelisht në një tjetër kontratë me të njëjtin Autoritet gjatë të njëjtën periudhë apo verifikimin e marrëdhënieve kontraktuale të autoritetit kontraktor me operatorët ekonomikë sikurse ankimuesi pretendon. Komisioni gjykon se pretendimet e cituara në ankesës nuk janë të mbështetura mbi ndonjë kriter, pra janë pretendime për një kriter të pakërkuar. Në këtë kuptim KPP gjykon, se këto pretendime nuk qëndrojnë, pasi janë mbështetur mbi kriteret të pakërkuar dhe të pa përcaktuar në Shtojcën 7 të dokumentave të tenderit. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi i kualifikimit i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa. Në mënyrë eksplicite, ligji për prokurimin publik parashikon, se vlerësimi i ofertave duhet bërë vetëm në përputhje me kriteret e kualifikimit të parashikuara në dokumentet e procedurës përkatëse. Vlerësimi i ofertave referuar kriterëve të tjera të kualifikimit, të cilat në asnjë rast nuk janë parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit, jo vetëm që është në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik, por çënon gjithashtu parimet kryesore të zhvillimit të

procedurës së prokurimit, parashikuar nga neni 3 i *lex specialis*, atë të barazisë në trajtimin e kërkesave dhe detyrimeve që i ngarkohen ofertuesve.

Sa më lart, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk qëndrojnë.

III.3.Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Verifikimin e angazhimeve të kapaciteteve financiare dhe teknike të operatorëve ekonomik “ALMO KONSTRUKSION” Shpk dhe “NDREGJONI” Shpk në kontratat e shpalluar fituese, **si edhe** kapacitetet financiare dhe teknike të deklaruar në këtë procedurë tenderi, sipas deklaratave përkatëse në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit si më poshtë:

B: DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se: Unë kam punonjës të nevojshëm siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.	Punonjës Po ☐ Jo ☐ Nëse, po, numri i punonjësve Gjithashtu, disponoj personelin kryesor të poshtëshënuar, sipas profileve (profesioneve/kualifikimeve) përkatëse: 1. _____, me profesion _____, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e _____, 2. _____, me profesion _____, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e _____, 3. _____, me profesion _____, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e _____, Makineri e mjete Po ☐ Jo ☐ Nëse, po, të listohen me të dhënat konkrete

C:DEKLARATË “PËR DISPONIMIN E MJETEVE/PAJISJE/MAKINERIVE TË NEVOJSHME PËR REALIZIMIN E PUNIMEVE OBJEKT KONTRATE”

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se, kam në dispozicion dhe/ose do të më vihenne dispozicion mjetet, pajisjet teknike dhe asetet e tjera fizike për të realizuar këtë kontratën, si më poshtë:

Me proces				
Lloji i Mjetit	Targa	Nr. Lejes qarkullimit	Nr. Shasisë	Të tjera
1				
2				
3				
4				
5				

Me qira					
Lloji i Mjetit	Targa e mjetit	Nr. Lejes qarkullimit të mjetit	Nr. Shasisë së mjetit	Nr. Kont së qerasë (noterisë)	Afati i kontratës qerasë(data e fillimit dhe mbarimit)
1					
2					
3					

Kontratë furnizimi				
Materiali/produkti për të cilin paraqitet kontrata e furnizimit	Nr. Kont së furnizimit (noterisë)	Afati i kontratës furnizimit (data e fillimit dhe mbarimit)	Të tjera	

D. Deklaratë mbi Mosangazhimin e Kapaciteteve Teknike në Kontrata Te Tjera

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se:

Mjetet/pajisjet/makineritë e deklaruara në këtë procedurë prokurimi, pavarësisht formës së disponimit të tyre, do të jene ne dispozicion gjatë zbatimit të kontratës sipas grafikut te punimeve.

Nëse kërkohet, stafi teknik i poshtëshënuar:

Z. _____, me profesion _____, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e _____,

etj .,

i deklaruar në këtë procedurë prokurimi, nuk është i angazhuar në asnjë kontratë apo punëmarrye tjetër publike, që bie ndesh me legjislacionin e fushës së ndërtimit, dhe do të angazhohet vetëm për realizimin e këtij objekti.

Emri, Mbiemri _____

Firma _____

Vula _____

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Bazuar në udhëzimin Nr.2 datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”.Pika 2.1 shprehet Përgjegjësi Teknik i kantierit, për veprat me vlerë të plotë mbi 30 000 000 (tridhjetë milion) lekë, duhet të jetë me kohë të plotë në objekt dhe i diplomuar në inxhinieri ndërtimi. Kërkojmë verifikimin nëse i njëjti drejtues kantieri është i angazhuar dhe në kontrata të tjera paralele”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.3.1. Në shtojcën 7 të dokumenteve të tenderit në pikën 2.3.3 , 2.3.4 2.3.5 e 2.3.6 të kriterëve të veçanta të kualifikimit autoriteti kontraktor ka parashikuar:

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor**, si më poshtë:

1 (nje) Inxhinier Ndërtimi

1 (nje) Inxhinier Hidroteknik

1 (nje) Inxhinier Mekanik

1 (nje) Inxhinier Elektrik

1 (nje) inxhinjer Mjedisi

1 (nje) inxhinier Gjeodet

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit 2.3.3 operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Diploma
- CV
- Kontrata e punës

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e personelit kryesor në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojces nr.8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.

Staf Mbeshtetes

1(Nje) Projektues Arkitekt (Licensa 2 a: Projektim arkitekturor për - objekte industriale - objekte turistike)

1(Nje) Projektues Konstruktor (Licensa 3 a: Projektim objekte civile – industrial – turistike, prej murature dhe skelet beton arme deri ne 5 kate.)

1(Nje) Projektues Instalator (Licensa 4 a,b,c,j:Projektim të instalimeve hidro-termosanitare, Projektim të instalimeve termoteknike-kondicionimi, si dhe të impianteve të prodhimit të energjisë termike nga burime të rinovueshme-Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale-Projektim të sistemeve kundra zjarrit- Projektim të rrjeteve të telefonisë, citofonisë, fonisë, internetit, TV, access controll, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e dedektimit të zjarrit etj., për objektet civile e industrial).

Stafi i sipërcituar është staf mbështetës për përgatitjen e projektit të zbatimit (Faza V-VI).

Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme për projekte të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë sipas përcaktimit në vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016”.

Për secilin punonjës të paraqitet diploma, kontrata e punes dhe CV.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e **personelit kryesor** në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese

2.3.4. Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/të kualifikuar**, si më poshtë:

- 1 (një) punonjës i pajisur me çertifikate “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” e cila të jetë e lëshuar nga Kryqi i Kuq ose shoqeri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- 1 (një) punonjës të disponojë çertifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier".

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

- Diplomë/certifikatë
- CV

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë prezencën në objekt të personelit të mësipërm dhe/ose të kërkojë ndryshimin/zëvendësimin e tyre me staf me kualifikime të njëjta ose më të larta, në rast konstatimi të shkeljeve të rregullave/normave përkatëse. Në rast përsëritje mund të merren masa për ndërprerjen e kontratës

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht 75 persona** për periudhën, 3 mujore nga momenti i hapjes së ofertave e vertetuar kjo me:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën 3 muajore nga momenti i hapjes së ofertave.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme në pronësi ose qira ose kontrate furnizimi

Nr	Emri i mjetit/pajisjes	Njesi	Sasia	Statusi
1	Ekskavator me Goma	Copë	1	Ne pronësi ose me qira
2	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës deri 20 Ton	Copë	2	Ne pronësi ose me qira
3	Kamion me kapacitet mbajtës nga 10 deri 25 Ton	Copë	1	Ne pronësi ose me qira
4	Kamioncine	Copë	2	Ne pronësi ose me qira
5	Kamion i pajisur me Vinc min 15 Ton	Copë	1	Ne pronësi ose me qira
6	Fadroma	Copë	1	Ne pronësi ose me qira
7	Autobot Uji	Copë	1	Ne pronësi ose me qira
8	Autobetoniere	Copë	2	Ne pronësi ose me qira
9	Autopompe	Copë	1	Ne pronësi ose me qira
10	Gjenerator	Copë	1	Ne pronësi ose me qira
11	Vibrator	Copë	2	Ne pronësi ose me qira
12	Betoniere min 350 Lt	Copë	2	Ne pronësi ose me qira
13	Asfaltoshtruese	Copë	1	Ne pronësi ose me qira
14	Autobitumatrice	Copë	1	Ne pronësi ose me qira
15	Rul Gome-Hekur	Copë	1	Ne pronësi ose me qira
16	Rul Hekur-Hekur	Copë	1	Ne pronësi ose me qira

Pajisjet dhe mjetet nuk duhet të jenë të angazhuara në asnjë kontratë tjetër publike, që bie ndesh me legjislacionin e fushës së ndërtimit, dhe do të angazhohet vetëm për realizimin e këtij objekti. Si dëshmi për të vërtetuar disponimin e mjeteve dhe pajisjeve teknike në pronësi/qira /kontrate furnizimi, do të paraqiten keto dokumenta:

- a) *Për mjetet me rrota që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (te vlefshme).*
- b) *Për mjetet e siguruara me qira, dokumenti që verteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, (te vlefshme) duhet të shoqerohet me kontraten perkatese të qerases/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.*
- c) *Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira të tij.*

Operatori/et ekonomik ofertues duhet të deklarojë që të gjitha mjetet dhe pajisjet e përkrahura, do të jenë të angazhuara vetëm në këto kontrata. Mjetet të cilat rezultojnë të angazhuara në kontrata të tjera afati i zbatimit të cilave shtrihet për gjatë afatit të kontratës objekt i prokurimit janë shkak skualifikimi. Autoriteti Kontraktor gezon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë disponueshmërinë e këtyre mjeteve si gjatë vlerësimit të ofertave ashtu edhe gjatë zbatimit të kontratës.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e mjeteve dhe pajisjeve në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

III.3.2. Në shtojcën 8 "Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit" të dokumenteve të tenderit në kriteret e vecanta të kualifikimit, autoriteti kontraktor, konkretisht në seksionet: B: DEKLARATË "Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate", C: Deklaratë "Për disponimin e mjeteve/pajisje/makinerive të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate" D: "Deklaratë mbi mosangazhimin e kapaciteteve teknike në kontrata të tjera", ka përcaktuar:

B: DEKLARATË "Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate"

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se: Unë kam punonjësit e nevojshëm siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.	Punonjës Po [] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve Gjithashtu, disponoj personelin kryesor të poshtëshënuar, sipas profileve (profesioneve/kualifikimeve) përkatëse: 1. _____, me profesion _____, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e _____, 2. _____, me profesion _____, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e _____, 3. _____, me profesion _____, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e _____, Makineri e mjete Po [] Jo [] Nëse, po, të listohen me të dhënat konkrete

C: DEKLARATË

“PËR DISPONIMIN E MJETEVE/PAJISJE/MAKINERIVE TË NEVOJSHME PËR REALIZIMIN E PUNIMEVE OBJEKT KONTRATE”

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se, kam në dispozicion dhe/ose do te me ne dispozicion mjetet, pajisjet teknike dhe asetet e tjera fizike për të realizuar këtë kontratën, si me poshte

Në pronësi				
Lloji i Mjetit	Targa	Nr. Lejes qarkullimit	Nr. Shasisë	Të tjera
1				
2				
3				
4				
5				

Me qira					
Lloji i Mjetit	Targa e mjetit	Nr. Lejes qarkullimit të mjetit	Nr. Shasisë së mjetit	Nr. Kont së qerasë (noterisë)	Afati i kontratës qerasë(data e fillimit dhe mbarimit)
1					
2					
3					
4					
5					
6					

Kontratë furnizimi				
Materiali/prod ukti për të cilin paraqitet kontrata e furnizimit	Nr. Kont së furnizimit (noterisë)	Afati i kontratës furnizimit (data e fillimit dhe mbarimit)	Të tjera	
1.				
2				
3				
4				

D. Deklaratë mbi Mosangazhimin e Kapaciteteve Teknike në Kontrata Te Tjera

Deklarata Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se: Mjetet/pajisjet/makineritë e deklaruara në këtë procedurë prokurimi, pavarësisht formës së disponimit të tyre, do të jënë në dispozicion gjatë zbatimit të kontratës sipas grafikut të punimeve. Nëse kërkohet, stafi teknik i poshtëshënuar: Z. _____, me profesion _____, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e _____, etj ., i deklaruar në këtë procedurë prokurimi, nuk është i angazhuar në asnjë kontratë apo punëmarrje tjetër publike, që bie ndesh me legjislacionin e fushës së ndërtimit, dhe do të angazhohet vetëm për realizimin e këtij objekti.
Emri, Mbiemri _____ Firma _____ Vula _____ Data e dorëzimit të deklaratës _____

III.3.3. Në përmbushje të kriterëve më sipër operatori ekonomik “Ndregjoni” SHPK, si përfaqësues i BOE “Ndregjoni Sh.p.k & “Rafin Company Sh.p.k “ ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE):

-Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të operatori ekonomik “Ndregjoni” SHPK, ku për seksionet e sipërcituara ka deklaruar si vijon:

B: DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontratë”

Deklarata Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se: Unë kam punonjësit e nevojshëm siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.	Përgjigje Punonjës Po ☒ Jo ☐ Nëse, po, numri i punonjësve : Muaji Korrik = 97 Punonjes Muaj Gusht 2025 = 94 Punonjes Muaji Shtator 2025 = 91 Punonjes Gjithashtu, disponoj personelin kryesor të poshtëshënuar, sipas profileve (profesioneve/kualifikimeve) përkatëse: Sipas pikes 2.3.3/ të DST-s: [Emri i punonjës] me numër personal [Numri i punonjës], me profesion Inxhinier Ndërtimi, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e Drejtues Teknik, kontratë pune Nr 15120 Rep dhe 7200 Kol, date 07/10/2023 deri më 07/10/2028, i pajisur me Diplomë Nr 1177-B nga Universiteti i Tiranës. [Emri i punonjës] me numër personal [Numri i punonjës], me profesion Inxhinier Hidroteknik, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e Drejtuesit Teknik, kontratë pune Nr 15121 Rep dhe 7201 Kol, datë 07/10/2023 deri më 07/10/2028, i pajisur me Diplomë Nr 3982 - B nga Universiteti i Tiranës. [Emri i punonjës] me numër personal [Numri i punonjës], me profesion Inxhinier Mekanik, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e Drejtues Teknik, kontratë pune Nr 15123 Rep dhe 7203 Kol, date 07/10/2023 deri më
---	---

Adresa : Rr. Sulej Rega, Nd. 32,118,
Kod Postar 1017 – Tiranë-Albania

Tel/Fax : + 355 42 374 853, Cel : + 355 68 20 36 734
Email : info@ndregjoni.al

07/10/2028, i pajisur me Diplomë Nr 1982 nga Universiteti Politeknik Tiranë, i pajisur me certifikatë për ushtrimin e profesionit “Ekspert Privat Zjarrfikës” me Nr. Amze 4123 nga Drejtoria e MZSH [Emri i punonjës] me numër personal [Numri i punonjës], me profesion Inxhinier Elektrik, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e Drejtues Teknik, kontratë pune Nr 16418 Rep dhe 7724 Kol, date 26/10/2023 deri më 26/10/2028, i pajisur me Diplomë Nr 3107 nga Universiteti Politeknik Tiranë. [Emri i punonjës] me numër personal [Numri i punonjës], me profesion Inxhinier Mjedisi, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e Drejtues Teknik, kontratë pune Nr 15124 Rep dhe 7204 Kol, date 07/10/2023 deri më 07/10/2028, i pajisur me Diplomë Nr 3018 nga Universiteti Politeknik Tiranë. [Emri i punonjës] me numër personal [Numri i punonjës], me profesion Inxhinier Gjeodet i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e Drejtues Teknik, kontratë pune Nr 15122 Rep dhe 7202 Kol, date 07/10/2023 deri më 07/10/2028, i pajisur me Diplomë Nr B-891 nga Universiteti i Tiranës. Sipas pikes 2.3.4 të DST-s : [Emri i punonjës] me numër personal [Numri i punonjës], me profesion inxhinieri hidroteknik, e punësuar pranë shoqërisë sonë me kontratë nr 59 prot, date 03/02/2025 deri më 03/02/2028 në rolin e stafit inxhinierik është paisur me Diplomë, Nr M-1448. Gjithashtu është pajisur me certifikata formim dhe trajnim për personat mbi “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” nga shoqëria Health Safety Environment Management paisur me License për formim profesional Nr. LC-8617-02-2017, dhe me certifikata nga Kryqi Kuq Shqiptar mbi “Për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”. Makinieri e mjete Po ☒ Jo ☐ Nëse, po, të listohen me të dhënat konkrete
--

C: DEKLARATË
"PËR DISPONIMIN E MJETEVE/PAJISJE/MAKINERIVE TË NEVOJSHME PËR REALIZIMIN E PUNIMEVE OBJEKT KONTRATË"

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se, kam në dispozicion dhe/ose do të me vihen

ne dispozicion mjetet, pajisjet teknike dhe asetet e tjera fizike për të realizuar këtë kontratën, si me poshte:

Në pronësi				
Lloji i Mjetit	Targa	Nr. Lejes qarkullimit	Nr. Shasisë	Të tjera
Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës deri në 20 ton	[REDACTED]	[REDACTED]	[REDACTED]	1 Cope
Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës nga 10 deri në 25 ton	AD-1710	[REDACTED]	[REDACTED]	1 Cope
Kamioncine	[REDACTED]	[REDACTED]	[REDACTED]	1 Cope
Gjenerator	N/A	N/A	Fature Tatimore	1 Cope
Vibrator	N/A	N/A	Fature Tatimore	2 Cope
Betoniere min 350 Lt	N/A	N/A	Fature Tatimore	2 Cope
Asfaltoshtruese	N/A	N/A	Fature Tatimore	1 Cope
Rrul Gome-Hekur	N/A	N/A	Deklarate Doganore	1 Cope
Rrul Hekur -Hekur	N/A	N/A	Deklarate Doganore	1 Cope

Me qira					
Lloji i Mjetit	Targa e mjetit	Nr. Lejes qarkullimit të mjetit	Nr. Shasisë së mjetit	Nr. Kont së qerasë	Afati i kontratës qerasë (data e fillimit dhe mbarimit)
Kamion me vine min 15 ton	[REDACTED]	[REDACTED]	501	[REDACTED]	24/10/2025 deri në përfundim të objektit
Autobot uji	[REDACTED]	[REDACTED]	025	Nr 7661 Kol	24/10/2023 24/10/2026
Autobetoniere	[REDACTED]	[REDACTED]	C90949	Nr 1344 Kol	17/10/2023 17/10/2028
Autobetoniere	[REDACTED]	[REDACTED]	C90950	Nr 1344 Kol	17/10/2023 17/10/2028
Autopompe	[REDACTED]	[REDACTED]	5130	Nr 1344 Kol	17/10/2023 17/10/2028

Kontratë furnizimi			
Materiali/prodakti për të cilin paraqitet kontrata e furnizimit	Nr. Kont së furnizimit (noterisë)	Afati i kontratës furnizimit (data e fillimit dhe mbarimit)	Të tjera

D. Deklaratë mbi Mosangazhimin e Kapaciteteve Teknike në Kontrata Te Tjera
Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se:

Mjetet/pajisjet/makinertë e deklaruara në këtë procedurë prokurimi, pavarësisht formës së disponimit të tyre, do të jenë në dispozicion gjatë zbatimit të kontratës sipas grafikut të punimeve.

Sipas pikës 2.3.3/ të DST-s:

[REDACTED] me numër personal [REDACTED], me profesion **Inxhinier Ndërtimi**, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e Drejtues Teknik, kontratë pune Nr 15120 Rep dhe 7200 Kol, date 07/10/2023 deri më 07/10/2028, i pajisur me Diplomë Nr 1177-B nga Universiteti i Tiranës.

[REDACTED] me numër personal [REDACTED], me profesion **Inxhinier Hidroteknik**, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e Drejtuesit Teknik, kontratë pune Nr 15121 Rep dhe 7201 Kol, date 07/10/2023 deri më 07/10/2028, i pajisur me Diplomë Nr 3982-B nga Universiteti i Tiranës.

[REDACTED] me numër personal [REDACTED], me profesion **Inxhinier Mekanik**, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e Drejtues Teknik, kontratë pune Nr 15123 Rep dhe 7203 Kol, date 07/10/2023 deri më 07/10/2028, i pajisur me Diplomë Nr 1982 nga Universiteti Politeknik Tiranë, i pajisur me certifikatë për ushtrimin e profesionit "Ekspert Privat Zjarrfikës" me nr. Amze 4123, nga Drejtoria e MZSH.

[REDACTED] me numër personal [REDACTED], me profesion **Inxhinier Elektrik**, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e Drejtues Teknik, kontratë pune Nr 16418 Rep dhe 7724 Kol, date 26/10/2023 deri më 26/10/2028, i pajisur me Diplomë Nr 3107 nga Universiteti Politeknik Tiranë.

[REDACTED] me numër personal [REDACTED], me profesion **Inxhinier Mjedisi**, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e Drejtues Teknik, kontratë pune Nr 15124 Rep dhe 7204 Kol, date 07/10/2023 deri më 07/10/2028, i pajisur me Diplomë Nr 3018 nga Universiteti Politeknik Tiranë.

[REDACTED] me numër personal [REDACTED], me profesion **Inxhinier Gjeodet**, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e Drejtues Teknik, kontratë pune Nr 15122 Rep dhe 7202 Kol, date 07/10/2023 deri më 07/10/2028, i pajisur me Diplomë Nr B-891 nga Universiteti i Tiranës.

Sipas pikës 2.3.4 të DST-s

[REDACTED] me numër personal [REDACTED], me profesion **inxhinier hidroteknik**, e punësuar pranë shoqërisë sonë me kontratë nr 59 prot, date 03/02/2025 deri më 03/02/2028 në rolin e stafit inxhinierik është e pajisur me Diplomë, Nr M-1448. Gjithashtu është pajisur me certifikatë formim dhe trajnim për personat mbi "Përgjegjësi për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" nga shoqëria Health Safety Environment Management pausur me License për formim profesional Nr. LC-8617-02-2017, dhe me certifikatë nga Kryqi Kuq Shqiptar mbi ekspert "Për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave". Etj

i deklaroj në këtë procedurë prokurimi, nuk është i angazhuar në asnjë kontratë apo punëmarrie tjetër publike, që bie ndesh me legjislacionin e fushës së ndërtimit, dhe do të angazhohet vetëm për realizimin e këtij objekti.

Emri, Mbiemri Xhetan Ndrejgoni
Firma _____
Vula _____
Data e dorëzimit të deklaratës 27.10.2025



Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të operatorit ekonomik “Rafin Company” SHPK ku për seksionet e sipërcituara ka deklaruar si vijon:

D. Deklarata e disponimit të punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekti kontrate

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se: Unë kam punonjësit e nevojshëm siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.	Punonjës Po [x] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve Korrik 2025 = [redacted] punonjës Gusht 2025 = [redacted] punonjës Shtator 2025 = [redacted] punonjës Mestarisht janë [redacted] punonjës



Rafin Company
Nderim-Montim-Imp-Exp

Adresa: Tiranë, Rruga "Hasan Kaka" (pjesa administrative nr 3 në pajtimet 338 II 1 sip 3)
 NIPET: 1521251104 Tel & Fax: Tel / Fax 003534271799 Mobile: +355 6820 44 447 / +355 68 37 44 447
 E-Mail: info@rafincompany.com / technical@rafincompany.com

Gjithashtu, disponoj personelin kryesor të poshtëshënuar, sipas profileve (profesioneve/kualifikimeve) përkatëse: Në plotësim të pikës 2.3.3	1. Z. [redacted] me profesion Inxhinier Ndërtimi, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e drejtuesit Teknik. Kontrate pune Nr. 6055 Rep/Nr. 1818 Kol, datë 24.10.2024 -afat i pacaktuar, me Diplomë Nr. 4435-B, lëshuar datë 15.05.1979, nga Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, Universiteti Politeknik i Tiranës. 2. [redacted] me profesion Inxhinier hidroteknik, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e drejtuesit Teknik. Kontratë pune Nr. 1653 Rep/ Nr. 571 Kol, datë 17.04.2024, afat 5 vjeçar, me të drejtë rinovimi, me Diplomë Nr. 6367-B, lëshuar datë 28.05.1981, nga Fakulteti i Inxhinierisë së Universitetit të Tiranës. Disponon licencën në projektim për pikën 3.a "Projektim objekte civile-industriale-turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 katë"
--	--



Rafin Company
Nderim-Montim-Imp-Exp

Adresa: Tiranë, Rruga "Hasan Kaka" (pjesa administrative nr 3 në pajtimet 338 II 1 sip 3)
 NIPET: 1521251104 Tel & Fax: Tel / Fax 003534271799 Mobile: +355 6820 44 447 / +355 68 37 44 447
 E-Mail: info@rafincompany.com / technical@rafincompany.com

3. [redacted] me profesionin Inxhinier elektrik , i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e drejtuesit Teknik. Kontratë pune Nr. 1655 Rep/ Nr. 573 Kol, datë 17.04.2024, afat 5 vjeçar, me të drejtë rinovimi, me Diplomë Nr. 5703-B, lëshuar datë 15.5.1979, nga Fakulteti i Inxhinierisë së Universitetit të Tiranës, në degën Elektrik. Disponon licencën në projektim për pikën 4.a "Projektim në instalimeve elektrike të ndërtimit dhe pikën 4.b "Projektim në instalimeve industriale-turistike-turistike, si dhe të drejtuesit të punësuar në shoqëri të ndërtimit".	
4. [redacted] me profesionin Inxhinier elektrik , i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e drejtuesit Teknik. Kontratë Pune Nr. 708 Rep/ Nr. 1392 Kol.	



Rafin Company
Nderim-Montim-Imp-Exp

Adresa: Tiranë, Rruga "Hasan Kaka" (pjesa administrative nr 3 në pajtimet 338 II 1 sip 3)
 NIPET: 1521251104 Tel & Fax: Tel / Fax 003534271799 Mobile: +355 6820 44 447 / +355 68 37 44 447
 E-Mail: info@rafincompany.com / technical@rafincompany.com

5. [redacted] me profesionin Inxhinier elektrik , i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e drejtuesit Teknik. Kontratë Pune Nr. 1366 Rep/ Nr. 837 Kol, datë 12.08.2024, me Diplomë Nr. 84.245 lëshuar datë 20.09.2012, nga Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, Universiteti Politeknik i Tiranës.	
6. [redacted] me profesionin Inxhinier elektrik , i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e drejtuesit Teknik. Kontratë Pune Nr. 1099 Rep/ Nr. 703 Kol, datë 14.07.2022, me afat 5 vjeçar, me të drejtë rinovimi, me Diplomë Nr. 2685-B, lëshuar datë 15.05.1979, nga Fakulteti i Inxhinierisë së Universitetit të Tiranës, dega e Elektricitetit.	
7. [redacted] me profesionin Inxhinier elektrik , i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e drejtuesit Teknik. Kontratë Pune Nr. 427 Rep/Nr. 154 Kol, datë 20.01.2024, me afat 5 vjeçar, me të drejtë rinovimi, me Diplomë Nr. 84.245 lëshuar datë 20.09.2012, nga Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, Universiteti Politeknik i Tiranës. Disponon licencën në projektim për pikën 2.a "Projektim ndërtimesh prej objekte turistike-industriale-turistike - objekte turistike"	



Ndërtim-Montim-Imp-Exp

Adresa : Tiranë, Rruga "Hashti Kika" njesia administrative nr.3 nr pasurise/338 H 1 ap 4
NIPIT: L521251104 Tel & Fax: Tel / Fax 003554273799; Mobile: +355 6820 44 447 /+355 66 37 44 447
E-Mail: info@rafincompany.com / technical@rafincompany.com

Në plotësim të pikës 2.3.4	
[Redacted] i punësuar pranë shoqërisë sonë në rolin e punonjësit "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" dhe "Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave" Makinëri e mjete Po [x] Jo [] Nëse, po, të listohen me të dhënat konkrete	

C: DEKLARATË

"PËR DISPONIMIN E MJETEVE/PAJISJE/MAKINERIVE TË NEVOJSHME

PËR REALIZIMIN E PUNIMEVE OBJEKT KONTRATË"

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se, kam në dispozicion dhe/ose do të me vihen në dispozicion mjetet, pajisjet teknike dhe asetet e tjera fizike për të realizuar këtë kontratën, si me poshte:

Në pronësi				
Lloji i Mjetit	Targa	Nr. Lejes qarkullimit	Nr. Shasisë	Të tjera
Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës deri në 20 ton	[Redacted]	[Redacted]	[Redacted]	1 copë
Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës deri në 20 ton	[Redacted]	[Redacted]	[Redacted]	1 copë
Kamion me kapacitet mbajtës nga 10 deri në 25 ton	[Redacted]	[Redacted]	[Redacted]	1 copë
Kamioncinë	[Redacted]	[Redacted]	[Redacted]	1 copë
Fadromë	[Redacted]	[Redacted]	[Redacted]	1 copë
Autopompë	[Redacted]	[Redacted]	[Redacted]	1 copë
Gjenerator	N/A	N/A	Faturë Tatimore	1 copë
Vibrator	N/A	N/A	Faturë Tatimore	2 cope
Betoniere mini 350 Lt	N/A	N/A	Faturë Tatimore	1 copë

COMPANY
Ndërtim-Montim-Imp-Exp

Adresa : Tiranë, Rruga "Hashti Kika" njesia administrative nr.3 nr pasurise/338 H 1 ap 4
NIPIT: L521251104 Tel & Fax: Tel / Fax 003554273799; Mobile: +355 6820 44 447 /+355 66 37 44 447
E-Mail: info@rafincompany.com / technical@rafincompany.com

Asfaltoshturuese	Vogële Super 1600 2	N/A	N/A	1 copë
Rul Gomë-hekur	CATERPILLAR	N/A	CATCS663KDAG00547	1 copë
Rul hekur-hekur	DYNAPAC TYPE CC1200	N/A	10000332K0A014530	1 copë

Me qira				
Lloji i Mjetit	Targa e mjetit	Nr. Lejes qarkullimit të mjetit	Nr. Shasisë së mjetit	Nr. Kont së qerasë
Eskavator me goma	[Redacted]	[Redacted]	[Redacted]	Rep Nr. 1133 Kol
Autobot uji	[Redacted]	[Redacted]	[Redacted]	Rep Nr. 1224 Kol
Autobetoniere	[Redacted]	[Redacted]	[Redacted]	Rep Nr. 1254 Kol
Autobitumatrice	[Redacted]	[Redacted]	[Redacted]	Rep Nr. 1734 Kol

Kontratë furnizimi			
Materiali/prodakti për të cilin paraqitet kontrata e furnizimit	Nr. Kont së furnizimit (noterisë)	Afati i kontratës furnizimit (data e fillimit dhe mbarimit)	Të tjera

D. Deklaratë mbi Mosangazhimin e Kapaciteteve Teknike në Kontrata Te Tjera

Deklarata
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se:

nëpunës përgjegjës për sigurimin e sigurimit të punës përmes kontraktit, përcaktues të punës në bashkëpunim me ty, dhe të jete me disponibilitet gjatë shërbimit të kontraktit sipas grafikut të punës.	
Nëse kërkohet, staff teknik i përcaktues:	
Në plotësim të pikës 2.3.3	
1.	[Redacted], i punësuar pranë shërbimit të punës, në rolin e drejtorit Teknik. Kontrakti punë Nr. 6655 Regj/ Nr. 1818 Kod, datë 24.10.2024, afat 5 vjeçar, me të drejtë rinovimi, me Diplomë Nr. 6367-B, lëshuar datë 15.05.1979, nga Fakulteti i Inzhinierisë së Ndërtimit, Universiteti Politeknik i Tiranës.
2.	[Redacted], i punësuar pranë shërbimit të punës, në rolin e drejtorit Teknik. Kontrakti punë Nr. 1653 Regj/ Nr. 573 Kod, datë 17.04.2024, afat 5 vjeçar, me të drejtë rinovimi, me Diplomë Nr. 6367-B, lëshuar datë 15.05.1979, nga Fakulteti i Inzhinierisë së Ndërtimit, Universiteti Politeknik i Tiranës. Disponon licencën në projektim për pikën 2.a "Projektim objekte civile-industriale-turistike prej marmeri e shërbime të tjera të tjera"
3.	[Redacted], i punësuar pranë shërbimit të punës, në rolin e drejtorit Teknik. Kontrakti punë Nr. 1655 Regj/ Nr. 573 Kod, datë 17.04.2024, afat 5 vjeçar, me të drejtë rinovimi, me Diplomë Nr. 3703-B, lëshuar datë 15.5.1978, nga Fakulteti i Inzhinierisë së Ndërtimit, Universiteti Politeknik i Tiranës. Disponon licencën në projektim për pikën 4.a "Projektim në inzhinieri hidropneumatike" dhe pikën 4.b "Projektim në inzhinieri hidropneumatike-konduktues, si dhe të instalimeve të prodhimit të energjisë termike nga fuqitë të rinovueshme."
4.	[Redacted], i punësuar pranë shërbimit të punës, në rolin e drejtorit Teknik. Kontrakti punë Nr. 700 Regj/ Nr. 199 Kod, datë 07.02.2025, afat 5 vjeçar, me të drejtë rinovimi, me Diplomë Nr. 1392, lëshuar datë 5.7.1991, nga Fakulteti i Inzhinierisë së Ndërtimit, Universiteti Politeknik i Tiranës. Disponon licencën në projektim për pikën 4.a "Projektim në inzhinieri hidropneumatike" dhe pikën 4.b "Projektim në inzhinieri hidropneumatike-konduktues, si dhe të instalimeve të prodhimit të energjisë termike nga fuqitë të rinovueshme."
5.	[Redacted], i punësuar pranë shërbimit të punës, në rolin e drejtorit Teknik. Kontrakti punë Nr. 1540 Regj/ Nr. 533 Kod, datë 12.04.2024, me Diplomë Nr. 245, lëshuar datë 20.09.2012, nga Fakulteti i Inzhinierisë së Ndërtimit, Universiteti Politeknik i Tiranës.
6.	[Redacted], i punësuar pranë shërbimit të punës, në rolin e drejtorit Teknik. Kontrakti punë Nr. 1994 Regj/ Nr. 705 Kod, datë 14.07.2021, me afat 5 vjeçar, me të drejtë rinovimi, me Diplomë Nr. 2985-B, lëshuar datë 15.05.1976, nga Fakulteti i Inzhinierisë së Ndërtimit, Universiteti Politeknik i Tiranës, dhe e Gjendur.
7.	[Redacted], i punësuar pranë shërbimit të punës, në rolin e stafit teknik. Kontrakti punë Nr. 527 Regj/ Nr. 114 Kod, datë 29.08.2017, me afat 5 vjeçar, me të drejtë rinovimi, me Diplomë Nr. 4374, lëshuar datë 29.08.2017, nga Fakulteti i Arkitekturës.

 Rafin Shërbime dhe Konsultime	
Adresa: Tiranë, Rruga "Dëshmorët e Kombit" Nr. 1, Kati i Parë, Shërbime dhe Konsultime NPT/121104 Tel & Fax: 061 460 4477, 061 460 4477, 061 460 4477 E-mail: info@rafin-sh.com, info@rafin-sh.com	
Në plotësim të pikës 2.3.4	
Ressida Petritaj i punësuar pranë shërbimit të punës në rolin e përcaktues "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shërbimit të punës" dhe "Ekspert për mbledhjen e parë dhe mbledhjen e ndaj emergjencave"	
Meqë kështu angazhimi në punë kontrakti apo përcaktuesi tjetër publik, që bën ndesh me legjislacionin e fuqishëm, si shërbimi, dhe të shërbimit të punës për realizimin e kësaj objekti.	
Emri, Shërbimi Ressida Petritaj	

III.3.4. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Në neni 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

Në nenin 77, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.
- Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë,

përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.3.5. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së; e)

operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

- g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;
- h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);
- i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;
- j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;
- k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- l) ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;
- ll) operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Në procedurat e prokurimit me faza, ky dokumentacion i kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit.

Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentat provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Për dokumentat e ofertës, të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik, ofertuesi i kualifikuar i pari duhet t'i paraqesë këto dokumenta në origjinal ose të njësuar me origjinalin. Gjithashtu, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njësuar me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”

III.3.7. Vendim Nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores eër kriteret dhe procedurat d dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar, parashikon se: Kreu I “Drejtues teknik”- individ/ët e diplomuar në degët përkatëse të universitetit që është/janë përgjegjës/a për ndërtimin e objekteve sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës”.

Ndërsa Kreu I, pika 2, e Udhëzimit Nr.2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, parashikon se: “Detyra e drejtuesit teknik të sipërmarrësit është e papajtueshme me çdo punëmarrje tjetër, publike a private, jashtë subjektit sipërmarrës.

2.1 Drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejt nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit.

Për vepra me vlerë të plotë, të preventuar mbi 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë pune të plotë në objekt dhe i diplomuar në inxhinieri ndërtimi.

2.2 Ndarja e detyrave dhe e përgjegjësiave të sipërmarrësit e të kantierit, marrëdhëniet me investitorin, mbikëqyrësin, administratën publike dhe rregulli në kantier përcaktohen në rregulloren e brendshme, që hartohet nga sipërmarrësi i punimeve.

III.3.8. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të

papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi. KPP-ja gjykon, se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma “dh”, se qëllimi i ligjit të prokurimit publik nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*” i ndryshuar si ligj material i zbatueshëm për shqyrtimin administrativ të ankesave të operatorëve ekonomikë, është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjithë palët në proces.

III.3.9. Sa më sipër, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi.

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues për operatorin ekonomik “Ndregjoni” SHPK “*....Kërkojmë verifikimin nëse i njëjti drejtues kantieri është i angazhuar dhe në kontrata të tjera paralele.*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se, pavarësisht se autoriteti kontraktor në kriteret e kualifikimit nuk ka përcatuar që drejtuesi teknik i deklaruar në këtë procedurë prokurimi nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo të deklaruar në procedura të shpallura fituese, procedura e prokurimit objekt ankimi është e natyrës punë, me fond limit 458,267,729.76 lekë (pa tvsh). Duke iu referuar ligjit sektorial të sektorit të zbatimit të punimeve në ndërtim, konkretisht VKM Nr.42, datë 16.1.2008 “*Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi*”, i ndryshuar, parashikon se: *Kreu I “Drejtues teknik”- individ/ët e diplomuar në degët përkatëse të universitetit që është/janë përgjegjës/a për ndërtimin e objekteve sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës*”, i cili është person që drejton punimet e zbatimit në kantier dhe merret me zbatimin me korrektësi të preventivit të punimeve sipas zërave të përcaktuar në të si edhe të zbatimit të projekt-zbatimit dhe specifikimeve teknike. Gjithashtu, në Udhëzimin Nr.2, datë 13.5.2005 “*Për Zbatimin e punimeve të ndërtimit*” i ndryshuar, “Kreu I, pika 2, parashikohet se: *Detyra e drejtuesit teknik të sipërmarrësit është e papajtueshme me çdo punëmarrje tjetër, publike a private, jashtë*

subjektit sipërmarrës.2.1_Drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejt nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit. Për vepra me vlerë të plotë, të preventuar mbi 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë pune të plotë në objekt dhe i diplomuar në inxhinieri ndërtimi, Pra, drejtuesi teknik i deklaruar në procedurën e prokurimit objekt ankimi, për shkak të natyrës dhe vlerës së kontratës duhet të jetë rezident, pra i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt. Nga shqyrtimi i materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ dhe konkretisht formulari i vetëdeklarimit i paraqitur në SPE nga operatori ekonomik “Ndregjoni” SHPK, si dhe informacioni i paraqitur nga autoriteti kontraktor në KPP përmes shkresës me nr. 192/1 prot., datë 16.01.2026, me lëndë “Dërgim dokumentacioni”, protokolluar me tonën me nr.3269/4 prot., bashkëlidhur të cilit gjendet formulari i vetëdeklarimit i procedurës së prokurimit në bazë të cilit është lidhur kontrata nr.4606, datë 19.11.2025 me objekt “Përmirësimi i Infrastrukturës së Parkimit Faza II: Ndërtim i godinës së parkimit nëntoksor dhe godinës së shërbimeve administrative, Himarë” (Godina e Re)”, mes autoritetit kontraktor dhe operatorit ekonomik “Ndregjoni” SHPK, rezulton se, në seksionin B Deklaratë: “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate” tek të dy formularët e sipërpërmendur të jetë deklaruar si drejtues teknik z.P.D, inxhinier ndërtimi, KPP referuar rrethanave dhe fakteve gjykon se operatori ekonomik “Ndregjoni” SHPK nuk e përmbush kriterin për drejtuesin teknik z. P.D, pasi nga verifikimi i formularit përmbledhës të deklarimit rezulton se drejtues teknik i deklaruar në këtë procedurë prokurimi është i deklaruar edhe në formularin e vetëdeklarimit për procedurën me objekt “Përmirësimi i Infrastrukturës së Parkimit Faza II: Ndërtim i godinës..” pra rezulton se drejtuesi teknik do të jetë i angazhuar edhe në kontrata të tjera, cka bie ndesh me ligjin sektorial, pasi referuar legjislacionit të fushës së ndërtimit të sipërpërmendur, drejtuesi teknik nuk është i angazhuar vetëm për realizimin e këtij objekti pra nuk është rezident, i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt.

Për sa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.3.10. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues për skualifikimin e operatorit ekonomik “Ndregjoni” SHPK, në procedurën e prokurimit objekt-ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se për sa kohë gjendja faktike e juridike e operatorit ekonomik “Ndregjoni” SHPK referuar arsyetimit të bërë në pikën III.3.9 të këtij vendimi do të ndryshojë nga e kualifikuar në të skualifikuar, duke përmbushur kështu interesin e ankimuesit, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk do të merren në shqyrtim, në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

III.4 Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues për “Verifikimin e angazhimeve të kapaciteteve financiare dhe teknike të operatorëve ekonomik ...” ALMO KONSTRUKSION” Shpk në kontratat e shpalluar fituese, si edhe kapacitetet financiare dhe teknike të deklaruar në

këtë procedurë tenderi, sipas deklaratave përkatëse në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit B: DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”, C: Deklaratë “për disponimin e mjeteve/pajisje/makinerive të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate”... D. Deklaratë mbi Mosangazhimin e Kapaciteteve Teknike në Kontrata Te Tjera... Bazuar në udhëzimin Nr.2 datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”. Pika 2.1 shprehet Përgjegjësi Teknik i kantierit, për veprat me vlerë të plotë mbi 30 000 000 (tridhjetë milion) lekë, duhet të jetë me kohë të plotë në objekt dhe i diplomuar në inxhinieri ndërtimi. Kërkojmë verifikimin nëse i njëjti drejtues kantieri është i angazhuar dhe në kontrata të tjera paralele.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.4.1 Në përmbushje të kriterëve më sipër operatori ekonomik “Almo Konstruksion” SHPK, si përfaqësues i BOE “Almo Konstruksion Sh.p.k & “Ina Sh.p.k “ ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE):

-Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të operatori ekonomik “Almo Konstruksion” SHPK dhe Ina” SHPK, si dhe të subjektit mbështetës “2 H Construction” ku,

Për seksionin B Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate” kanë deklaruar si vijon:

2H- CONSTRU CTION sh.p.k	M04619001 D	- kapacitetet njerëzorë (fuqinë punëtore) sipas 1.Licenses 2 a: Projektim arkitekturor për - objekte industriale - objekte turistike) 2. Licenses (Licensa 3 a: Projektim objekte civile – industrial – turistike, prej murature dhe skelet beton	Punonjës Po [x] Jo [] Operatori ekonomik “ALMO Konstruksion shpk”, do të mbështetet në kapacitetet njerëzorë (fuqinë punëtore), të subjektit mbështetës 2H-CONSTRUCTION sh.p.k, i cili do të vërë në dispozicion stafin si dhe licencën me kategorite perkatese te projektimit si me poshte: 1. Z. Gjergj Haxhiu me profesion Arkitekt i punesuar prane
-----------------------------------	----------------	--	---

Zall – Mner i Ri, Rruga Nacionale Kamez, 1054, Tirane -Albania



+355 67 60 06 776
info@almokonstruksion.com
www.almokonstruksion.com

		arme deri ne 5 kate.) 3. Licenses 4 a,b,c,j:Projektim të instalimeve hidro- termosanitare, Projektim të instalimeve termoteknike- kondicionimi, si dhe të impianteve të prodhimit të energjisë termike nga burime të rinovueshme- Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale- Projektim të sistemeve	shoqerise 2H-CONSTRUCTION sh.p.k, në rolin e Projektuesit Arkitekt – sipas (Licenses 2 a: Projektim arkitekturor për - objekte industriale - objekte turistike.) 2. Z. Hekuran Haxhalli me profesion inxhinier ndertimi i punesuar prane shoqerise 2H- CONSTRUCTION sh.p.k, në rolin e projektuesit konstruktor sipas (Licensa 3 a: Projektim objekte civile – industrial – turistike, prej murature dhe skelet beton arme deri ne 5 kate.) 3. Z. Hekuran Haxhalli me profesion inxhinier elektrik i punesuar prane
--	--	--	---

			4. [redacted] me profesion inxhinier hidroelektrik i punësuar pranë shoqërisë [redacted] 211-CONSTRUCTION sh.p.k. në rolin e projektuesit instalator sipas (Licensa 4 a,b,c,j:Projektim të instalimeve hidro-termosanitare, Projektim të instalimeve
--	--	--	--



Zall – Mner i Ri, Rruga Nacionale Kamez, 1054, Tiranë -Albania



+355 67 60 06 776
info@almokonstruksion.com
www.almokonstruksion.com

			termoteknike-kondicionimi, si dhe të impianteve të prodhimit të energjisë termike nga burime të rinovueshme-Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale-Projektim të sistemeve kundra zjarrit-Projektim të rrjeteve të telefonisë, citofonisë, fonisë, internetit, TV, access kontrolli, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e dedektimit të zjarrit etj., për objektet civile e industriale).
			5. [redacted] me profesion inxhinier mekanik i punësuar pranë shoqërisë [redacted] 211-CONSTRUCTION sh.p.k. në rolin e projektuesit instalator sipas (Licensa 4 a,b,c,j:Projektim të instalimeve hidro-termosanitare, Projektim të instalimeve termoteknike-kondicionimi, si dhe të impianteve të prodhimit të energjisë termike nga burime të rinovueshme-Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale-Projektim të sistemeve kundra zjarrit-Projektim të rrjeteve të telefonisë, citofonisë, fonisë, internetit, TV, access kontrolli, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e dedektimit të zjarrit etj., për objektet civile e industriale).
			6. [redacted] me profesion inxhinier elektrik i punësuar pranë



info@almokonstruksion.com
www.almokonstruksion.com

B: DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se: Unë kam punonjësit e nevojshëm siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/entë kontraktor.	Punonjës Nëse, po, numri i punonjësve, [redacted] (Korrik – shtator 2025) Gjithashtu, disponoj personelin kryesor të poshtëshënuar, sipas profileve (profesioneve/kualifikimeve) përkatëse: 1. [redacted], me profesion Inxhinieri ndërtimi (Drejtes Teknik), e punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e Inxhinieres së ndërtimit (drejtueses teknike) me nr diplome M-1150 me titull Inxhinieri ndërtimi (Profili Infrastruktura e Transportit) dhe Kontrate individuale pune Nr.2398 Rep Nr.1157 Kol. 2. [redacted], me profesion inxhinier hidroteknik i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e inxhinierit hidroteknik 3. [redacted], me profesion inxhinier elektrik, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e inxhinierit Elektrik 4. [redacted], me profesion inxhinier Mjedisit, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e inxhinier te Mjedisit, 5. [redacted], me profesion inxhinier gjeodet, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e inxhinierit gjeodet 6. [redacted], i punësuar pranë shoqërisë sone, në rolin Ekspert per Ndihmen e Pare dhe Nderhyrjen ndaj emergjencave. 7. [redacted], i punësuar pranë shoqërisë sone, në rolin e Përgjegjes per sigurine dhe mbrojtjen e shendetit ne pune



B: DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se: Unë kam punonjësit e nevojshëm siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.	Punonjës Po ☒ Jo ☐ Nëse, po, numri i punonjësve Korrik 10, Gusht 91, Shtator 10 Gjithashtu, disponoj personelin kryesor të poshtë shënuar, sipas profileve (profesioneve/kualifikimeve)përkatëse: Z. [Emri i punonjës], me profesion Inxhinier Ndërtimi, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e Inxhinierit të Ndërtimit. Znj. [Emri i punonjës] me profesion Inxhinier Hidroteknike, e punësuar pranë shoqërisë sonë në rolin e Inxhinieres Hidroteknike. Z. [Emri i punonjës] me profesion Inxhinier Mekanik, i punësuar pranë shoqërisë sonë në rolin e Inxhinierit Mekanik. Z. [Emri i punonjës] me profesion Inxhinier Elektrik, i punësuar pranë shoqërisë sonë në rolin e Inxhinierit Elektrik. Znj. [Emri i punonjës] me profesion Inxhinier Mjedisi e punësuar pranë shoqërisë sonë në rolin e Inxhinieres së mjedisit Z. [Emri i punonjës] me profesion Inxhinier Gjeodet, i punësuar pranë shoqërisë sonë në rolin e Inxhinierit Gjeodet. Z. [Emri i punonjës] me profesion Inxhinier Gjeodet, i punësuar pranë shoqërisë sonë në rolin e Ekspertit për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave. Z. [Emri i punonjës] me profesion Inxhinier Gjeolog, i punësuar pranë shoqërisë sonë në rolin e Përgjegjësit për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë. Makinëri e mjete Po ☐ Jo ☐ Nëse, po, të listohen me të dhënat konkrete Sipas Deklaratës Bashkangjitur

B: DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se: Unë kam punonjësit e nevojshëm siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.	Punonjës Po ☒ Jo ☐ Nëse, po, numri i punonjësve Gjithashtu, disponoj personelin kryesor të poshtëshënuar, sipas profileve (profesioneve/kualifikimeve) përkatëse: Operatori ekonomik “ALMO Konstrksion shpk”, do të mbështetet në kapacitetet njerëzore (fuqinë punëtore), të subjektit mbështetës “2H –CONSTRUCTION sh.p.k”, i cili do të vërë në dispozicion stafin sipas pikave të licenses si me poshte 1. [Emri i punonjës] me profesion Arkitekt i punësuar pranë shoqërisë 2H–CONSTRUCTION sh.p.k, në rolin e Projektuesit Arkitekt – sipas (Licenses 2 a: Projektim arkitekturor për - objekte industriale - objekte turistike.) 2. [Emri i punonjës] me profesion inxhinier ndërtimi i punësuar pranë shoqërisë 2H–CONSTRUCTION sh.p.k, në rolin e projektuesit instalator sipas (Licensa 3 a: Projektim objekte civile – industrial – turistike, prej murature dhe skelet beton arme deri në 5 kate.) 3. Z. [Emri i punonjës] me profesion inxhinier elektrik i punësuar pranë shoqërisë 2H–CONSTRUCTION sh.p.k, në rolin e projektuesit instalator sipas (Licensa 4 a,b,c,j:Projektim të instalimeve hidrotermosanitare. Projektim të instalimeve termoteknike-kondicionimi, si dhe të impianteve të prodhimit të energjisë termike nga burime të rinovueshme-Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale-Projektim të sistemeve kundra zjarrit- Projektim të rrjeteve të telefonisë, citofonisë, fonisë, internetit, TV, access kontroll, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e dedektimit të zjarrit etj., për objektet civile e industriale). 4. [Emri i punonjës] me profesion inxhinier hidroeknik i punësuar pranë shoqërisë 2H–CONSTRUCTION sh.p.k, në rolin e projektuesit instalator sipas (Licensa 4 a,b,c,j:Projektim të instalimeve hidrotermosanitare. Projektim të instalimeve termoteknike-kondicionimi, si dhe të impianteve të prodhimit të energjisë termike nga burime të

	rinovueshme-Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale-Projektim të sistemeve kundra zjarrit- Projektim të rrjeteve të telefonisë, citofonisë, fonisë, internetit, TV, access controll, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e dedektimit të zjarrit etj., për objektet civile e industriale). 5. [Redacted] me profesion inxhinier mekanik i punësuar pranë shoqërisë 2H-CONSTRUCTION sh.p.k. në rolin e projektuesit instalator sipas ((Licensa 4 a,b,c,j):Projektim të instalimeve hidro-termosanitare. Projektim të instalimeve termoteknike-kondicionimi, si dhe të impianteve të prodhimit të energjisë termike nga burime të rinovueshme-Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale-Projektim të sistemeve kundra zjarrit- Projektim të rrjeteve të telefonisë, citofonisë, fonisë, internetit, TV, access controll, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e dedektimit të zjarrit etj., për objektet civile e industriale). 6. [Redacted] me profesion inxhinier elektrik i punësuar pranë shoqërisë 2H-CONSTRUCTION sh.p.k. në rolin e projektuesit instalator sipas ((Licensa 4 a,b,c,j):Projektim të instalimeve hidro-termosanitare. Projektim të instalimeve termoteknike-kondicionimi, si dhe të impianteve të prodhimit të energjisë termike nga burime të rinovueshme-Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale-Projektim të sistemeve kundra zjarrit- Projektim të rrjeteve të telefonisë, citofonisë, fonisë, internetit, TV, access controll, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e dedektimit të zjarrit etj., për objektet civile e industriale). Makineri e mjete Po [] Jo [] Nëse, po, të listohen me të dhënat konkrete
--	--



Për seksionin C Deklaratë “për disponimin e mjeteve/pajisje/makinierive të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate” kanë deklaruar si vijon:



info@almokonstruksion.com
www.almokonstruksion.com

DEKLARATË

PËR DISPONIMIN E MJETEVE/PAJISJE/MAKINIERIVE TË NEVOJSHME

PËR REALIZIMIN E PUNIMEVE OBJEKT KONTRATE

Unë cilësoj se operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se, kam në dispozicion dhe/ose do të me vihen e dispozicion mjetet, pajisjet teknike dhe asetet e tjera fizike për të realizuar këtë kontratën, si me poshte:

Në pronësi				
Lloji i Mjetit	Targa	Nr. Lejes qarkullimit	Nr. Shasisë	Të tjera
Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtes deri 20 ton				
Kamioncine				
Fadrome				dt.17.4.2008
Gjenerator				dt.01.06.2006
Vibrator betoni	2 cope			16.04.2019
Betoniere min 350 lt	6 cope			24.02.2016
Asfaltoshtruese				dt.04.09.2004
Rrvi për ngjeshje Asfalti 6.6 ton (Hekur-Hekur)				



+355 67 60 06 776
info@almokonstruksion.com
www.almokonstruksion.com

Me qira					
Lloji i Mjetit	Targa e mjetit	Nr. Lejes qarkullimit të mjetit	Nr. Shasisë së mjetit	Nr. Kont së qerasë (noterisë)	Afati i kontratës qerasë(data e fillimit dhe mbarimit)
Enkavator me goma me targa					perfundim objekti
Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtes 10-25 ton					perfundim objekti
Kamioncine					
Kamion me vline min 15 ton					

Autobot uji					perfundim objekti
Autobetoniere					perfundim objekti
Rrul Gome Hekur					perfundim objekti
Autobitumatri ce e pajisur me certifikate transport mallrash te rezukshem					02.10.2023-Deti perfundim objekti
Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes deri 20 ton					



C: DEKLARATË

"PËR DISPONIMIN E MJETEVE/PAJISJE/MAKINERIVE TË NEVOJSHME PËR REALIZIMIN E PUNIMEVE OBJEKT KONTRATE"

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se, kam në dispozicion dhe/ose do te me vihen ne dispozicion mjetet, pajisjet teknike dhe asetet e tjera fizike për të realizuar këtë kontratën, si me poshte:

Në pronësi				
Lloji i Mjetit	Targa	Nr. Lejes qarkullimit	Nr. Shasisë	Të tjera
Vibrator 2X				
Gjenerator				

Me qira					
Lloji i Mjetit	Targa e mjetit	Nr. Lejes qarkullimit të mjetit	Nr. Shasisë së mjetit	Nr. Kont së qerasë (noterisë)	Afati i kontratës qerasë(data e fillimit dhe mbarimit)
Ekskavator me Goma			70		
Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtës deri 20 Ton					
Kamion me kapacitet mbajtës nga 10 deri 25 Ton			92		
Kamioncine			75		
Kamioncine			20		



Fadroma					
Autobot Uji			827		
Autobetoniere			80		
Autobetoniere			50		
Autopomp Betoni			25		
Asfaltoshtruese					
Autobitumatrice					
Rul Gome-Hekur					
Rul Hekur-Hekur					

Për seksionin D. Deklaratë mbi Mosangazhimin e Kapaciteteve Teknike në Kontrata Te Tjera” kanë deklaruar si vijon:



+355 67 60 00 170
info@almokonstruksion.com
www.almokonstruksion.com

D. Deklaratë mbi Mosangazhimin e Kapaciteteve Teknike në Kontrata Te Tjera

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se:

Mjetet/pajisjet/makinieritë e deklaruar në këtë procedurë prokurimi, pavarësisht formës së disponimit të tyre, do të jënë në dispozicion gjatë zbatimit të kontratës sipas grafikut të punimeve.

Nëse kërkohet, stafi teknik i poshtëshënuar:

1. [Emri i punësuarit], me profesion Inxhinier ndertimi (Drejtues Teknik), e punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e Inxhinierit të ndertimit (drejtueses teknike) me nr diplome M-1150 me titull Inxhinier ndertimi (Profili Infrastruktura e Transportit) dhe Kontrate individuale pune Nr. 2598 Rep Nr. 1151 Rep.
2. Z. [Emri i punësuarit], me profesion inxhinier hidroteknik i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e inxhinierit hidroteknik
3. Z. [Emri i punësuarit], me profesion inxhinier elektrik, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e inxhinierit Elektrik
4. Z. [Emri i punësuarit], me profesion inxhinier Mjedisi, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e inxhinierit të Mjedisit,
5. Z. [Emri i punësuarit], me profesion inxhinier gjeodet, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e inxhinierit gjeodet
6. Z. [Emri i punësuarit], i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin Ekspert për Ndihmën e Përveç dhe Nderhyrjen ndaj emergjencave.
7. Z. [Emri i punësuarit], i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë ,etj .,

i deklaruar në këtë procedurë prokurimi, nuk është i angazhuar në asnjë kontratë apo punëmarje tjetër publike, që bie ndesh me lehtësuesin e fushës së ndërtimit dhe do të angazhohet vetëm për realizimin e këtij objekti.



D. Deklaratë mbi Mosangazhimin e Kapaciteteve Teknike në Kontrata Te Tjera

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se:

Vjetet/pajisjet/makinieritë e deklaruara në këtë procedurë prokurimi, pavarësisht formës së disponimit të tyre, do të jenen në dispozicion gjatë zbatimit të kontratës sipas grafikut të punimeve.

Nëse kërkohet, stafin teknik i poshtëshënuar:

Z. [Emri i Personit], me profesion Inxhinier Ndertimi, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e Inxhinierit të Ndertimit. Profili Strukturist.

Znj. [Emri i Personit] me profesion Inxhinier Hidroteknike, e punësuar pranë shoqërisë sonë në rolin e Inxhinieres Hidroteknike.

Z. [Emri i Personit] me profesion Inxhinier Mekanik, i punësuar pranë shoqërisë sonë në rolin e Inxhinierit Mekanik.

Z. [Emri i Personit] me profesion Inxhinier Elektrik, i punësuar pranë shoqërisë sonë në rolin e Inxhinierit Elektrik.

Znj. Shpresa Shpami me profesion Inxhinier Mjedisi e punësuar pranë shoqërisë sonë në rolin e Inxhinieres së mjedisit.

Z. [Emri i Personit] me profesion Inxhinier Gjeodet, i punësuar pranë shoqërisë sonë në rolin e Inxhinierit Gjeodet.

Z. Kristo Veto me profesion Inxhinier Gjeodet, i punësuar pranë shoqërisë sonë në rolin e Ekspertit për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave.

Z. [Emri i Personit] me profesion Inxhinier Gjeolog, i punësuar pranë shoqërisë sonë në rolin e Përgjegjësit për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë.

I dekluar në këtë procedurë prokurimi, nuk është i angazhuar në asnjë kontratë apo punëmarrje tjetër publike, që bie ndesh me kapacitetin e funksionit të ndërtimit dhe do të angazhohet vetëm në realizimin e kësaj objekti.

III.4.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimes “-Verifikimin e angazhimeve të kapaciteteve financiare dhe teknike të operatorëve ekonomik “ALMO KONSTRUKSION” Shpk në kontratat e shpalluar fituese, si edhe kapacitetet financiare dhe teknike të deklaruara në këtë procedurë tenderi, sipas deklaratave përkatëse në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit” si më poshtë: B: DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se autoriteti kontraktor në kriteret e kualifikimit 2.3.3, 2.3.4 dhe 2.3.5 ka përcaktuar personelin e nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate sikurse paraqitet në pikën III.3.2 të këtij vendimi. Të tre kriteret e sipërpërmendur konsiderohen të përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit dhe vetëm përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit autoriteti kontraktor i kërkon ofertuesit të renditur i pari dorëzimin e dokumentave provuese..

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton, se për përmbushjen e kriterëve të veçanta të kualifikimit, si më sipër cituar, secili prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Almo Konstrksion”& Ina “SHPK ka dorëzuar formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, dokument të cilin, në zbatim të parashikimeve ligjore në fuqi, autoriteti/enti kontraktor e pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, dhe vetëm përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike, duke i rezervuar në këtë mënyrë të

drejtën autoritetit kontraktor të kryejë verifikime në rast nevojë apo të dërgojë kërkesa për sqarim, mbi dokumentacionin e paraqitur nga operatorët ekonomikë.

Konkretisht:

Operatori ekonomik “Almo Konstruksion ” SHPK ka deklaruar në Pjesën III: *Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit* , B: *DEKLARATË Për disponimin e punonjësve të nevojshme* për realizimin e punimeve objekt kontrate” se ka punonjës të nevojshëm, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërteton këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor, sikurse paraqitet në pikën III.4.1 të këtij vendimi, e më konkretisht ka deklaruar: x punonjës, për periudhën (Korrik – Shtator) 2025, duke deklaruar personelin sipas profileve përkatëse: znj. E.H inxhinier ndërtimi, z. J.V inxhinier hidroteknik, z. E.M, inxhinier elektrik, z. E.A inxhinier mjedisi, z.N.H inxhinier gjeodet, z. B.P ekspert për ndihmën e parë, z. H.Zh, përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë. Gjithashtu, operatori ekonomik “2 H-Construction” SHPK, si subjekt mbështetës i operatorit ekonomik “Almo Konstruksion” SHPK, sa i takon fuqisë punëtore, ka deklaruar në rubrikën përkatëse të formularit të vetdeklarimit personelin sipas profileve përkatëse: Z.Gj. K me profesion arkitekt, z.H.H inxhinier ndërtimi, z. D H inxhinier elektrik, z. D.Gj inxhinier Hidroteknik, z. E.M inxhinier mekanik.

Operatori ekonomik “Ina” SHPK ka deklaruar në Pjesën III: *Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit* , B: *DEKLARATË Për disponimin e punonjësve të nevojshme* për realizimin e punimeve objekt kontrate” se ka punonjës të nevojshëm, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërteton këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor, sikurse paraqitet në pikën III.4.1 të këtij vendimi ,e më konkretisht ka deklaruar: për periudhën Korrik x punonjës, Gusht x dhe Shtator x, si dhe personelin sipas profileve përkatëse: Z.K.Zh, Inxhinier Ndërtimi, Znj.M.Sh, Inxhinier Hidroteknike, Z.V.K, Inxhinier Mekanik, Z.E.D me profesion Inxhinier Elektrik, Znj.Sh.Sh me profesion Inxhinier Mjedis, Z.A.Z Inxhinier Gjeodet, Z.K.N me profesion Inxhinier Gjeodet, i punësuar në rolin e Ekspertit për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave, Z.Ferdinand Çausi me profesion Inxhinier Gjeolog, i punësuar në rolin e Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë.

Nisur nga sa parashtruar më sipër, Komisioni gjykon se punonjës të deklaruar nga BOE “Almo Konstruksion”& Ina “SHPK, e subjekt mbështetës “ 2H- Konstruksion” SHPK janë në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor të përcaktuara në pikat 2.3.3,2.3.4 e 2.3.5 të dokumentave të tenderit, çka sjell mospranimin e pretendimit të operatorit ekonomik ankimes për mosplotësim të këtyre kriterëve të kualifikimit, pra personelit të nevojshëm për realizimin e kontratës objekt ankimi, nga ky bashkim operatorësh ekonomikë.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimes nuk qëndron.

III.4.3. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “-Verifikimin e angazhimeve të kapaciteteve financiare dhe financiare dhe teknike të operatorëve ekonomik “ALMO KONSTRUKSION” Shpk në kontratat e shpalluar fituese, si edhe kapacitetet financiare dhe teknike të deklaruar në këtë procedurë tenderi, sipas deklaratave përkatëse në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit” si më poshtë: C: Deklaratë “Për disponimin e mjeteve/pajisje/makinerive të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se, autoriteti kontraktor në kriterin e kualifikimit 2.3.6 ka përcaktuar mjetet dhe pajisjet e nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate sikurse paraqitet në pikën III.3.2 të këtij vendimi. Kriteri i sipërpërmendur konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit, dhe vetëm përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit autoriteti kontraktor i kërkon ofertuesit të renditur i pari dorëzimin e dokumentave provuese. Referuar përcaktimit të bërë lidhur me pajisjet dhe mjetet, konstatohet se autoriteti kontraktor ka të drejtë të verifikojë disponueshmërinë e këtyre mjeteve si gjatë vleresimit të ofertave ashtu edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në rastin objekt gjykimi konstatohet se kohëzgjatja e kontratës, referuar përcaktimit të bërë në njoftimin e kontratës, është 24 muaj, për rrjedhojë për mjetet e deklaruar “me qira” kërkohet kontratë qiraje e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës.

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton, se për përmbushjen e kriterit të veçantë të kualifikimit 2.3.6, secili prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Almo Konstrksion”& Ina “ SHPK ka dorëzuar formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Konkretisht:

Operatori ekonomik “Almo Konstruksion” SHPK ka deklaruar në Pjesën III: *Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit C: Deklaratë “Për Disponimin e Mjeteve/Pajisje/Makinerive të Nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate se ka në dispozicion dhe/ose do të me vihen në dispozicion mjetet, pajisjet teknike dhe asetet e tjera fizike për të realizuar këtë kontratë, si më poshtë*, sikurse paraqitet në pikën III.4.1 të këtij vendimi. Gjithashtu, operatori tjetër ekonomik Ina SHPK, pjesë e BOE “Almo Konstrksion’ &”Ina” SHPK ka deklaruar në rubrikën përkatëse C: Deklaratë “Për Disponimin e Mjeteve/Pajisje/Makinerive.., sikurse paraqitet në pikën III.4.1. të këtij vendimi.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërpërmendur, (formularëve të vetëdeklarimit të secilit operator ekonomik pjesë e BOE) Komisioni konstaton se, prej BOE “Almo Konstrksion”& Ina “SHPK, deklarimi i bërë për mjetet e kërkuara në pikën 2.3.6 të dokumentave të tenderit nuk është sipas përcaktimit të autoritetit kontraktor për mjetet si më poshtë; “Autobetoniere” në sasinë 2 copë, në pronësi ose me qera dhe Autopompe betoni në sasinë 1 copë në pronësi ose me qera, e konkretisht: Rezulton se prej këtij BOE , lidhur me kërkesën e autoritetit kontraktor për mjet autobetonier, në sasinë 2 copë, nga operatori ekonomik “Almo Konstruksion” SHPK është deklaruar autobetoniere me identifikimin XXX me kohëzgjatje të kontratës së qerasë deri në përfundim objekti, ndërsa prej operatorit ekonomik “Ina”SHPK janë deklaruar 2 autobetoniere

me identifikimin (targë) XXX dhe XXX dhe kohëzgjatje të kontratës së qerasë 11.12.2024–11.12.2026. Ndërsa, lidhur me kërkesën e autoritetit kontraktor për mjet “Autopompë betoni” në sasinë 1 copë, rezulton se prej OE Almo Konstrksion nuk është deklaruar një mjet i tillë, ndërsa prej OE “Ina”SHPK është deklaruar Autopompë betoni me targë xxx në sasinë 1 copë, e kohëzgjatje të kontratës së qerasë 11.12.2024–11.12.2026.

Sa më sipër, Komisioni konstaton se prej bashkimit të operatorëve ekonomikë deklarimi i bërë prej operatorit ekonomik ‘Ina’ SHPK, si pjesë e BOE “Almo Konstrksion”& Ina “SHPK, lidhur me 2 (dy) autobetoniere, me identifikimin xxx dhe xxx me kohëzgjatje të kontratës së qerasë 11.12.2024–11.12.2026 dhe 1 (një) Autopompë betoni me targë xxx me kohëzgjatje të kontratës së qerasë 11.12.2024–11.12.2026, nuk është i vlefshëm, pasi nuk përfshin gjithë periudhën e realizimit të kontratës. KPP gjykon, se operatori ekonomik “Ina” SHPK, si pjesë e BOE “Almo Konstrksion”& Ina “SHPK, duhej të dorëzonte në sistemin elektronik të prokurimeve të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, e më konkretisht me afat vlefshmërie të mjeteve me qera përgjatë gjithë zbatimit të kontratës prej 24 muaj. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion. Përsa më sipër, Komisioni gjykon se deklarimi i bërë në formularin përmbledhës të vedeklarimit, nga operatori ekonomik “Ina” SHPK, si pjesë e BOE “Almo Konstrksion”& Ina “SHPK, lidhur me mjetin autobetonier dhe autopompë me kohëzgjatje të kontratës së qerasë 11.12.2024–11.12.2026, nuk është i vlefshëm, ndaj autoriteti kontraktor duhet të rivlerësoj ofertën e BOE ‘Almo Konstrksion’ & Ina SHPK sipas konstatimeve të shprehura në këtë vendim.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron pjesërisht.

III.4.4 Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues për operatorin ekonomik “Almo Konstrksion” SHPK “....Kërkojmë verifikimin nëse i njëjti drejtues kantieri është i angazhuar dhe në kontrata të tjera paralele.”, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se, sikurse ka arsyetuar në pikën III.3.9 të këtij vendimi, pavarësisht se autoriteti kontraktor në kriteret e kualifikimit nuk ka përcatuar që drejtuesi teknik i deklaruar në këtë procedurë prokurimi nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo të deklaruar në procedura të shpallura fituese, procedura e prokurimit objekt ankimi është e natyrës punë, me fond limit 458,267,729.76 lekë (pa tvsh). Duke iu referuar ligjit sektorial të sektorit të zbatimit të punimeve në ndërtim, konkretisht VKM Nr.42, datë 16.1.2008 “Për Miratimin E Rregullores Për Kriteret Dhe Procedurat E Dhënies Së Licencave Profesionale Të Zbatimit, Klasifikimit Dhe Disiplinimit Të Subjekteve Juridike, Që Ushtrjnë Veprimtari Ndërtimi”, i ndryshuar, parashikon se: Kreu I “Drejtues teknik”- individi/ët e diplomuar në degët përkatëse të universitetit që është/janë përgjegjës/a për ndërtimin e objekteve sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës”, i cili është person që drejton punimet e zbatimit në kantier dhe merret me zbatimin me korrektësi të preventivit të punimeve sipas zërave të përcaktuar në të si edhe të zbatimit të projekt-zbatimit dhe specifikimeve teknike.

Gjithashtu, në Udhëzimin Nr.2, datë 13.5.2005 “Për Zbatimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, parashikon se “Kreu I, pika 2, Detyra e drejtuesit teknik të sipërmarrësit është e papajtueshme me çdo punëmarrje tjetër, publike a private, jashtë subjektit sipërmarrës.2.1 Drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejt nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit. Për vepra me vlerë të plotë, të preventuar mbi 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë pune të plotë në objekt dhe i diplomuar në inxhinieri ndërtimi, Pra, drejtuesi teknik i deklaruar në procedurën e prokurimit objekt ankimi, për shkak të natyrës dhe vlerës së kontratës duhet të jetë rezident, pra i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt. Nga shqyrtimi i materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ dhe konkretisht formulari i vetëdeklarimit i paraqitur në SPE nga operatori ekonomik “Almo Konstruksio” SHPK, si dhe informacioni i paraqitur nga autoriteti kontraktor në KPP përmes shkresës me nr. 192/1 prot., datë 16.01.2026, me lëndë “Dërgim dokumentacioni”, protokolluar me tonën me nr.3269/4 prot., bashkëlidhur të cilit gjendet formulari i vetëdeklarimit i procedurës së prokurimit në bazë të cilit është lidhur kontrata nr.4645, datë 25.11.2025 me objekt “Transformim urbannë hapësira publike kryesore, Rajoni 4: Rikualifikimi i rrugës “Butrinti”, Sarandë””, mes autoritetit kontraktor dhe operatorit ekonomik “Almo Konstruksion” SHPK, rezulton se, në seksionin B Deklaratë: “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate” tek formulari i vetëdeklarimit për procedurën e prokurimit objekt ankimi të jetë deklaruar si drejtues teknik znj.E.H, inxhinier ndërtimi, ndërsa për procedurën e prokurimit me objekt Transformim urbannë hapësira publike kryesore, Rajoni 4: Rikualifikimi i rrugës “Butrinti”, Sarandë””, të jetë deklaruar z. E.B, inxhinier ndërtimi. KPP referuar rrethanave dhe fakteve gjykon se operatori ekonomik “Almo Konstruksion” SHPK e përmbush kriterin për drejtuesin teknik, pasi nga verifikimi i formularit përmbledhës të deklarimit rezulton se drejtues teknik i deklaruar në këtë procedurë prokurimi znj.E.H nuk është i deklaruar edhe në formularin e vetëdeklarimit për procedurën me objekt “Transformim urbannë hapësira publike kryesore, Rajoni 4: Rikualifikimi i rrugës “Butrinti”, Sarandë”” pra rezulton se drejtuesi teknik i procedurës objekt ankimi nuk do të jetë i angazhuar edhe në kontrata të tjera, sikurse përcaktohet edhe në ligjin sektorial, pasi referuar legjislacionit të fushës së ndërtimit të sipërpërmendur, drejtuesi teknik është i angazhuar vetëm për realizimin e këtij objekti pra është rezident, i pranishëm gjatë gjithë gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt.

Për sa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.5.Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues se nuk janë dhënë në mënyrë të detajuar vlerësimet me pikë për çdo kriter nga tre anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave.... Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se, nga verifikimi i raportit të auditit për procedurën e prokurimit objekt ankimi, vlerësimi i bërë prej anëtarëve të komisionit të vlerësimit është bërë konform përcaktimit të bërë nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit në pikën 4.4 të njoftimit të kontratës. Po ashtu, nga verifikimi i bërë këtij vlerësimi në SPE me atë të paraqitur nga autoriteti kontraktor me shkresën nr. 192/1 prot., datë 16.01.2026, me lëndë “Dërgim

dokumentacioni”, protokolluar me tonën me nr.3269/4 prot, rezulton se ky vlerësim është i njëjtë.

Për sa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Zdrava” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur”, me nr. REF-64104-10-08-2025, me objekt: “Ndërtimi i infrastruktures së modeleve të integruara në zona me potencial zhvillimi, Divjakë: “Ferma e dijes dhe agroturizmit të ullishteve, Divjakë”, me fond limit 458,267,729.76 lekë (pa tvsh), zhvilluar me date 27.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.
2. Autoriteti kontraktor të rivlerësojë ofertën e operatorit ekonomik “Ndregjoni” SHPK dhe operatori ekonomik “Almo Konstruksion” SHPK, sipas konstatimeve të shprehura në këtë vendim.
3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të njoftojë Komisionin e Prokurimit Publik mbi zbatimin e vendimit duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Zdrava” SHPK
5. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiovent Zguro

